



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

*Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike - Ministarstvo
Ekonomije, Zapošlavanja, Trgovine, Industrije, Preduzetništva i Strateških Investicija - Ministry of Economy,
Employment, Trade, Industry, Entrepreneurship and Strategic Investments*

RREGULLORE (MEPTINIS) NR. 03/2020 PËR PRODUKTET E PARAPAKETUARA

REGULATION(MEETIESI) NO. 03/2020 ON PREPACKED PRODUCTS

UREDBU (EZTIPSI) BR. 03/2020 O PREDPAKOVANIM PROIZVODIMA

Ministrja e Ministrisë së Ekonomisë, Punësisë, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investime Strategjike Në mbështetje të nenit 29 të Ligjit Nr. 06/L - 037 për Metrologji (Gazeta Zyrtare, Nr. 7, 08.05.2018) , nenit 8 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.4 të Rregullores (QRK) Nr. 05/2020 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38, paragrafit 6, të Rregullores Nr. 09/2011, së Punës të Qeverisë së Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare nr.15.12.09.2011), Nxjerrë: RREGULLORE (MEPTINIS) NR. 03/2020 PËR PRODUKTET E PARAPAKETUARA Neni 1 Qëllimi 1. Qëllimi i kësaj Rregullore është që të përcaktojë kriteret dhe rregullat për sasinë nominale të produkteve të para-paketuara. 2. Kjo Rregullore është në përputhje me Direktivën e Këshillit të datës 20 janar 1976	Minister of the Ministry of Economy, Employment, Trade, Industry, Entrepreneurship and Strategic Investments Pursuant to Article 29 of the Law No. 06/L-037 on Metrology, (Official Gazette, Nr. 7, 08.05.2018) Article 8, paragraph 1, subparagraph 1.4, and Annex 7 of the Regulation (GRK) - No. 05/2020 on the Areas of Administrative Responsibility of the Office of Prime Minister and Ministries and Article 38, paragraph 6, of the Regulation No. 09/2011 of Rules and Procedures of the Government of Republic of Kosovo (Official Gazette No. 15, 12.09.2011) Issues: REGULATION (MEETIESI) NO. 03/2020 ON PREPACKED PRODUCTS Article 1 Purpose 1. The purpose of this Regulation is to set out the criteria and rules for nominal quantities of pre-packaged products. 2. This Regulation is compliant with the Council directive of 20 January 1976 on the	Ministarka Ministarstvo Ekonomije, Zapošlavanja, Trgovine, Industrije, Preduzetništva i Strateških Investicija Na osnovu člana 29 Zakona Br. 06/L-037 o metrologiji, (Službeni glasnik Nr. 7, 08.05.2018), člana 8. stav 1. tačka 1.4, i Aneksa 7, Uredbe (VRK) Br. 05/2020, o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i Ministarstava, kao i na osnovu člana 38. stav 6. Pravilnika Br. 09/2011, o radu Vlade Republike Kosovo, (Službeni list br.15, 12.09.2011), Donosi: UREDBA (MEZTIPSI) BR. 03/2019 O PREDPAKOVANIM PROIZVODIMA Član 1 Svrha 1. Svrha ove Uredbe je da definiše kriterijume i pravile za nominalne količine predpakovanih proizvoda. 2. Ova uredba je u skladu sa Direktivom Saveta od 20. januara 1976. o usklađivanju
---	---	--

mbi përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me përgatitjen sipas masës ose vëllimit të disa produkteve të parapaketuara (76/211/EEC) të ndryshuar nga Direktiva 2007/45/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 5 shtator 2007 që përcakton rregullat për sasi të nominale për produktet e parapaketuara. Neni 2 Fushëveprimi 1. Kjo rregullore zbatohet për parapaketimet që përmbajnë produkte të destinuara për shitje në sasi konstante nominale të njësive të cilat janë: 1.1. të barabarta me vlerat e paracaktuara nga paketuesi; 1.2. të shprehura në njësi të masës ose vëllimit, 1.3. jo më pak se 5 g ose 5 ml dhe jo më shumë se 10 kg ose 10 litra. 2. Kjo Rregullore nuk zbatohet për produktet e listuara në Shtojcën III, të cilat shiten në dyqanet pa doganë për konsum.	approximation of the laws of the Member States relating to the making-up by weight or by volume of certain prepackaged products (76/211/EEC) as amended by the Directive 2007/45/EC of the European Parliament and of the Council of 5 September 2007 laying down rules on nominal quantities for prepacked products. Article 2 Scope 1. This Regulation relates to prepackages containing products intended for sale in constant unit nominal quantities which are: 1.1. equal to values predetermined by the packer; 1.2. expressed in units of weight or volume, 1.3. not less than 5 g or 5 ml and not more than 10 kg or 10 l. 2. This Regulation shall not apply to the products listed in the Annex III which are sold in duty-free shops for consumption.	zakona država članica u vezi sa sastavljanjem određenih predpakovanih proizvoda po masu ili zapremini (76/211/EEC) sa izmenama i dopunama iz Direktive 2007/45/EC Evropskog parlamenta i Saveta od 5. septembra 2007. o utvrđivanju pravila o nazivnim količinama za predpakovane proizvode. Član 2 Područje 1. Ova Uredba se odnosi na predpakovane proizvode kojom se obuhvataju proizvodi namenjeni za prodaju u konstantnim nominalnim količinama, koje su: 1.1. jednake vrednostima koje je unapred odredio paker; 1.2. izražene u jedinicama mase ili zapremine, 1.3. ne manje od 5 g ili 5 ml i ne veće od 10 kg ili 10 l. 2. Ova uredba se ne primjenjuje na proizvode navedene u Aneksu III koji se prodaju u bescarinskim malim trgovinama za potrošnju.
---	--	---

Neni 3 Produktet e parapaketuara 1. Një produkt i parapaketuar (në tekstin e mëtejshëm: parapaketimet) brenda kuptimit të kësaj Rregullore është kombinimi i një produkti dhe paketimi individual në të cilin është i parapaketuar. 2. Një produkt është i parapaketuar kur vendoset në një paketë të çfarëdo natyre pa qenë i pranishëm blerësi dhe sasia e produktit që përmban paketa ka një vlerë të paracaktuar dhe nuk mund të ndryshohet pa paketën ose të hapen ose të kalojnë një modifikim të perceptueshëm.	Article 3 Prepackaged products 1. A prepacked product (hereinafter: prepackages) within the meaning of this Regulation is the combination of a product and the individual package in which it is prepacked. 2. A product is prepacked when it is placed in a package of whatever nature without the purchaser being present and the quantity of product contained in the package has a predetermined value and cannot be altered without the package either being opened or undergoing a perceptible modification.	Član 3 Predpakovani proizvodi 1. Predpakovani proizvod (u daljem tekstu: predpakovani proizvod) u smislu ove uredbe je kombinacija proizvoda i pojedinačnog pakovanja u kojem je taj proizvod unapred upakovan. 2. Proizvod je predpakovan kada se stavi u pakovanje bilo koje vrste bez prisustva kupca, a količina proizvoda sadržana u pakovanju ima unapred određenu vrednost i ne može se menjati bez otvaranja paketa ili prolaska kroz primetnu modifikaciju.
Neni 4 Shënjimi 1. Parapaketimet të cilat mund të shënohen me shenjën "e" të specifikuar në pikën 3.3 të Shtojcës I, janë ato parapaketime që janë në përputhje me këtë Rregullore. 2. Parapaketimet do t'i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe kontroleve metrologjike siç janë rregulluar në nenet 42 dhe 43 të Ligjit për Metrologjinë dhe në kushtet e përcaktuara në Shtojcën 1, pika 5 dhe në Shtojcën II.	Article 4 Marking 1. The prepackages which may be marked by the sign "e" specified in section 3.3 of Annex I are those which comply with this Regulation. 2. They shall be subject to metrological supervision and surveillance as regulated in Articles 42 and 43 of the Law on Metrology and under the conditions defined in Annex 1, section 5 and in Annex II.	Član 4 Obeležavanje 1. Predpakovanih proizvodi koji mogu biti označene znakom „e“ koji su navedeni u odeljku 3.3 Aneksa I su oni koje su u skladu sa ovom Uredbom. 2. Oni podležu metrološkom nadzoru i nadzoru, kao što je regulisano u članovima 42 i 43 Zakona o Metrologiji i pod uslovima definisanim u Aneksu II, odeljak 5 i Aneksu 2.

Neni 5 Masa nominale dhe vëllimi nominal 1. Të gjitha parapaketimet e përcaktuara në nenin 4 të kësaj Rregullore duhet të tregojnë masën ose vëllimin e produktit, në përputhje me Shtojcën I, të njohur si 'masa nominale' ose 'vëllimi nominal', të cilat është e kërkuar që t'i përmbajnë. 2. Parapaketimet që përmbajnë produkte të lëngëta do të shënohen me vëllimin e tyre nominal dhe parapaketimet që përmbajnë produkte të tjera do të shënohen me masën nominale të tyre, përveç nëse legjislacioni në fuqi parashikon ndryshe ose, në mungesë të një legjislacioni të tillë, zbatohen praktikatat tregtare. 3. Shpërndarësit/spërkatësit e aerosoleve duhet të tregojnë kapacitetin total nominal të enës. Treguesi duhet të jetë i tillë që të mos krijojë konfuzion me vëllimin nominal të përmbajtjes. 4. Produktet që shiten në formën e aerosoleve nuk duhet të shënohen me masën nominale të përmbajtjes së tyre.	Article 5 Nominal weight and nominal volume 1. All prepackages referred to in Article 4 of this Regulation must, in accordance with Annex I, bear an indication of the weight or volume of the product, known as 'nominal weight' or 'nominal volume', which they are required to contain. 2. Prepackages containing liquid products shall be marked with their nominal volume and prepackages containing other products shall be marked with their nominal weight, unless the applicable legislation provides otherwise or, in the absence of such legislation, commercial practices are applied. 3. Aerosol dispensers shall indicate the nominal total capacity of the container. The indication shall be such as not to create confusion with the nominal volume of the contents. 4. Products which are sold in aerosol dispensers need not be marked with the nominal weight of their contents.	Član 5 Nominalna masa i nominalna zapremina 1. Svi predpakovani proizvodi navedeni u članu 4 iz ove Uredbe moraju, u skladu sa Aneksom I, da nose oznaku mase ili zapremine proizvoda, poznate kao „nominalna masa“ ili „nominalna zapremina“, koju oni moraju da sadrže. 2. Predpakovani proizvodi koje sadrže tečne proizvode moraju biti označene njihovom nominalnom zapreminom, a predpakovani proizvodi koje sadrže druge proizvode moraju biti označeni njihovom nominalnom masom, osim ako važeći zakon ne predviđa drugačije ili, u odsustvu takvog zakonodavstva, primenjuju se komercijalne prakse. 3. Aerosolni raspršivači moraju naznačiti nominalni ukupni kapacitet boce. Indikacija mora biti takva da ne stvara konfuziju sa nominalnom zapreminom sadržaja. 4. Proizvodi koji se prodaju u aerosolnim raspršivačima ne moraju biti označeni nominalnom masom njihovog sadržaja.
Neni 6 Vendosja në treg	Article 6 Placing on the market	Član 6 Stavljanje na tržište

1. Vendosja në treg e parapaketimeve që plotësojnë kërkesat dhe testet e përcaktuara në këtë Rregullore për arsyet që kanë të bëjnë me shenjat që kërkohen të vendosen në parapaketimet e tilla në pajtim me këtë Rregullore, përcaktimi i vëllimit ose i masës së tyre ose metodave me të cilat ato janë matur ose kontrolluar, nuk mund të refuzohet, ndalohet ose kufizohet. 2. Agjencia e Metrologjisë së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: AMK) duhet të sigurojë që produktet e cekura në pikën 2 të Shtojcës III dhe të cilat janë të vendosura në parapaketime, në intervalet e cekura në pikën 1 të Shtojcës III, plasohen në treg vetëm nëse janë të parapaketuara në sasi të nominale të listuara në pikën 1 të Shtojcës III.	1. The marketing of prepackages which satisfy the requirements and tests laid down in this Regulation for reasons concerning the markings required to be borne by such prepackages pursuant to this Regulation, the determination of their volume or weight, or the methods by which they have been measured or checked, may not be refused, prohibited or restricted. 2. Kosovo Metrology Agency (hereinafter: KMA) shall ensure that the products listed in section 2 of the Annex III and put up in prepackages in the intervals listed in section 1 of the Annex III are placed on the market only if they are prepacked in the nominal quantities listed in section 1 of the Annex III.	1. Stavljanje na tržište predpakovanih proizvoda koji zadovoljavaju zahteve i testove utvrđene ovim Pravilnikom, iz razloga koji se odnose na oznake koje se moraju podneti za takve predpakovanih proizvode u skladu sa ovom Uredbom, određivanje njihove zapremine ili mase, ili metode kojima su izmerene ili proverene, ne mogu biti odbijene, zabranjene ili ograničene. 2. Kosovska Agencija za Metrologiju (u daljem tekstu: KAM) će obezbediti da proizvodi navedeni u odeljku 2 iz Aneksa III i stavljeni u predpakovane proizvode u intervalima navedenim u odeljku 1 Aneksa III budu stavljeni na tržište samo ako su predpakovani u nominalnim količinama navedenim u odeljku 1 iz Aneksa III.
Neni 7 Paketimet e shumëfishta 1. Kur dy ose më shumë parapaketime individuale përbëjnë një paketim të shumëfishtë, sipas nenit 6 të kësaj Rregullore, sasi të nominale të cekura në pikën 1 të Shtojcës III do të zbatohen për çdo parapaketim individual. 2. Kur një parapaketim përbëhet nga dy ose më shumë paketa individuale të cilat nuk kanë për qëllim të shiten ndaras, sasi të nominale të	Article 7 Multipacks 1. For the purposes of Article 6 of this Regulation, where two or more individual prepackages make up a multipack, the nominal quantities listed in section 1 of the Annex III shall apply to each individual prepackage. 2. Where a prepackage is made up of two or more individual packages which are not intended to be sold individually, the nominal	Član 7 Višestruki paketi 1. U smislu člana 6 iz ove Uredbe, kada dva ili više pojedinačnih pakovanja čine multi pakovanje, nominalne količine navedene u odeljku 1 Aneksa 3 primenjuju se na svaki pojedinačno predpakovan proizvod. 2. Kada se predpakovani proizvod sastoji od dva ili više pojedinačnih pakovanja koja nisu namenjena za pojedinačnu prodaju, nominalne količine navedene u odeljku 1

cekura në pikën 1 të Shtojcës III do të vlejnjë për atë parapaketim.	quantities listed in section 1 of the Annex III shall apply to the prepackage.	Aneksa III primenjuju se na predpakovani proizvod.
Neni 8 Detyrimet e prodhuesit/importuesit 1. Prodhuesi dhe/ose importuesi i parapaketimeve duhet ta njoftojë AMK-në mbi emrin e tyre zyrtar, adresën dhe numrin e regjistrimit të kompanisë. 2. AMK krijon dhe mirëmban një regjistër elektronik të prodhuesve dhe importuesve të parapaketimeve. 3. Subjektet nga paragrafi 1 i këtij neni janë të detyruar ta njoftojnë AMK-në për çdo ndryshim të rëndësishëm pas regjistrimit. 4. Nëse prodhuesi apo importuesi nuk i përmbahet këtij neni për të plotësuar kërkesat për regjistrim sipas nenit 32 të Ligjit për Metrologjinë, atëhere vlejnjë dispozitat e nenit 46 të Ligjit për Metrologji.	Article 8 Obligations of manufacturer/importer 1. Manufacturer or/and importer of prepackages shall inform KMA of their official name, address and their company registration number. 2. KMA establishes and maintains an electronic register of prepackages manufacturers and importers. 3. Subjects from paragraph 1 of this Article shall be obliged to inform KMA of any relevant change following the registration. 4. If the manufacturer or importer does not comply with this Article to fulfill the registration requirements under Article 32 of the Law on Metrology, then the provisions of Article 46 of the Law on Metrology shall apply.	Član 8 Obaveze proizvođača/uvoznika 1. Proizvođač ili uvoznik predpakovanih će obavestiti KAM o svom zvaničnom imenu, adresi i registracionom broju svoje kompanije. 2. KAM uspostavlja i vodi elektronski registar proizvođača i uvoznika predpakovanja. 3. Subjekti iz stava 1. ovog člana dužni su da obaveste KAM o svim relevantnim promenama nakon registracije. 4. Ako proizvođač ili uvoznik ne postupi u skladu sa ovim članom da bi ispunio uslove za registraciju iz člana 32. Zakona o metrologiji, primeniće se odredbe člana 46. Zakona o metrologiji.
Neni 9 Dispozitat kalimtare 1. Dispozitat e nenit 4 paragrafi 1, të kësaj Rregullore për shënimin e parapaketimeve	Article 9 Transitional Provisions 1. Provisions of Article 4 paragraph 1 of this Regulation on marking of prepackages shall	Član 9 Prelazne odredbe 1. Odredbe člana 4 stav 1 iz ove Uredbe o označavanju predpakovanih proizvoda se

zbatohen nga dita e pranimi të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian. 2. Para pranimi të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian, të gjitha shenjat e vendosura në mënyrë të ligjshme në parapaketimet, të mbuluara nga kjo Rregullore, pranohen/njihen nga AMK-ja gjatë kryerjes së kontrollit të tregut dhe aktiviteteve të mbikëqyrjes. Neni 10 Dispozitat shfuqizuese Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja për Parapaketimet (MTI) Nr. 03/2018. Neni 11 Shtojcat e Rregullores 1. Shtojcat I, II, III dhe IV janë pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje: I. Objektivat dhe dispozitat themelore; II. Metodat e kontrollit; III. Diapazonet e sasive nominale të përmbajtjes të parapaketimeve;	be applied from the day of accession of the Republic of Kosovo to the European Union. 2. Before the accession of the Republic of Kosovo to the European Union all markings lawfully placed on prepackages covered by this Regulation, shall be accepted/recognized by KMA when performing market supervision and surveillance activities. Article 10 Repeal of existing provisions With effect from entering into force of this Regulation the Regulation on Prepackages (MTI) No. 03/2018 is repealed. Article 11 Annexes of the Regulation 1. Annexes I, II, III and IV are integral part of this Regulation I. Objectives and basic provisions; II. Methods of control; III. Range of nominal quantities of contents of prepackages;	primjenjuje od dana pristupanja Republike Kosovo Evropskoj uniji. 2. Pre pristupanja Republike Kosovo Evropskoj uniji sve oznake koje su zakonito stavljene na prepakovanih proizvode obuhvaćene ovom Uredbom, će biti prihvaćene/priznate od strane KAM kada sprovedu poslove nadzora i kontrole tržišta. Član 10 Ukidajuće odredbe Stupanjem na snagu ove Uredbe, ukida se Uredba o prepakovanim proizvodima (MTI) Br. 03/2018. Član 11 Prilogi Odredbe 1. Sastavni deo ove Uredbe je Prilog I, II, III i IV. I. Ciljevi i osnovne odredbe; II. Metode kontrole; III. Raspored nominalnih količina za sadržaj prepakovanih proizvoda;
--	--	--

IV. Shenja evropiane "e" e konformitetit të parapaketimeve. Neni 12 Hyrja në fuqi Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare. Rozeta HAJADARI Ministre Prishtinë, 05.05.2020	IV. European "e" conformity mark of pre-packages. Article 12 Entry into force This Regulation shall enter into force seven (7) days following publication in the Official Gazette. Rozeta HAJADARI Minister Prishtina, 05.05 .2020	IV. Evropska oznaka "e" o usklađenosti pretpakovina. Član 12 Stupanje na snagu Ova uredba stupa na snagu sedam (7) dana nakon objavljivanja u Službenom listu. Rozeta HAJADARI Ministarka Priština, 05. 05.2020
--	--	---



SHTOJCA I

OBJEKTIVAT DHE DISPOZITAT THEMELORE

1. OBJEKTIVAT

Parapaketimet e mbuluara nga kjo rregullore duhet të kompletohen në atë mënyrë që paketat e kompletuara të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

1.1. përmbajtja aktuale nuk do të jetë më e vogël, mesatarisht, sesa ajo nominale;

1.2. përqindja e parapaketimeve që kanë një gabim negativ më të madh se gabimi i tolerueshëm negativ i përcaktuar në tabelë tek 2.4 duhet të jetë mjaft i vogël për grupet (seritë) e parapaketimeve për të përmbushur kërkesat e testeve të specifikuara tek Shtojca II;

1.3. asnjë parapaketim që ka një gabim negativ më të madh se dyfishi i gabimit të tolerueshëm negativ të dhënë në tabelë tek 2.4 nuk mund të mbajë shenjën "e" të përcaktuar tek Shtojca 4.

2. PËRKUFIZIMET DHE DISPOZITAT THEMELORE

2.1. Sasia nominale (masa nominale ose vëllimi nominal) i përmbajtjes së një parapaketimi është masa ose vëllimi i treguar në parapaketim, domethënë sasia e produktit të cilën supozohet të përmbajë parapaketimi.

2.2. Përmbajtja aktuale e parapaketimit është sasia (masa ose vëllimi) i produktit të cilin në fakt ai e përmban. Në të gjitha operacionet për kontrollimin e sasive të produkteve të shprehura në njësi të vëllimit, vlera e përdorur për përmbajtjen aktuale duhet të matet ose korrigjohet në një temperaturë prej 20 °C, pavarësisht nga temperatura në të cilën kryhet paketimi ose kontrolli. Megjithatë, ky rregull nuk zbatohet për produktet thellë të ngrira ose të ngrira, sasia e të cilave shprehet në njësi vëllimore.

2.3. Gabimi negativ i një parapaketimi është sasia me të cilën përmbajtja aktuale e parapaketimit është më e vogël se sa sasia nominale.

2.4. Gabimi i tolerueshëm negativ në përmbajtjen e një parapaketimi është rregulluar në përputhje me tabelën e mëposhtme:

Sasia nominale, Q_n në gram ose mililitra	Gabimi i tolerueshëm negativ	
	si % e Q_n	g ose ml
5 to 50	9	-
nga 50 deri 100	-	4,5
nga 100 deri 200	4,5	-
nga 200 deri 300	-	9
nga 300 deri 500	3	-
nga 500 deri 1000	-	15
nga 1000 deri 10000	1,5	-

Kur përdoret tabela, vlerat e gabimeve negative të tolerueshme të paraqitura si përqindje në tabelë, të llogaritura në njësi të masës ose vëllimit, duhet të rrumbullakohen deri në një të dhjetën e një gramit ose mililitrit më të afërt.

3. MBISHKRIMET DHE SHËNJIMET

Të gjitha paketimet e bëra në përputhje me këtë Rregullore duhet të mbajnë në paketim shënjimet e mëposhtme të vendosura në mënyrë të tillë që të jenë të pashlyeshme, lehtësisht të lexueshme dhe të dukshme në parapaketim në kushte normale të prezantimit:

3.1. Sasia nominale (masa nominale ose vëllimi nominal) i shprehur në kilogram, gram, litër, centilitër ose mililitër dhe e shënjuar në shifra në madhësi të paktën 6 mm nëse sasia nominale tejkalon 1 000 g ose 100 cl, 4 mm e lartë nëse është nga 1 000 g ose 100 cl përfshirëse deri në 200 gram ose 20 cl, 3 mm të larta nëse është nga 200 g ose 20 cl deri në 50 gram ose 5 cl, 2 mm e lartë nëse nuk është më shumë se 50 g ose 5 cl, pasuar nga simboli për njësinë e matjes së përdorur ose kur është e përshtatshme me emrin e njësisë në përputhje me rregullat që rregullojnë njësitë e matjes;

3.2. një markë ose mbishkrim që mundëson AMK-në të identifikojë paketuesin ose personin që rregullon paketimin ose importuesin;

3.3. një shkronjë 'e' me madhësi të paktën 3 mm, e vendosur në fushën e njëjtë të të pamurit, sikurse treguesi i masës nominale ose vëllimit nominal, duke përbërë një garanci nga paketuesi ose importuesi që parapaketimi i plotëson kërkesat e kësaj Rregulloreje.

Kjo shkronjë 'e' duhet të ketë formën e treguar në vizatimi që gjendet tek Shtojca 4.

4. PËRGJEGJËSIA E PAKETUESIT OSE IMPORTUESIT

Paketuesi ose importuesi është përgjegjës për të siguruar që parapaketimet i përmbushin kërkesat e kësaj Rregullore.

Sasia e produktit që përmban një parapaketim (ose sasia e paketimit), i njohur si 'përmbajtja aktuale', duhet të matet ose kontrollohet sipas masës ose vëllimit mbi përgjegjësinë e paketuesit dhe/ose importuesit. Matja ose kontrolli duhet të kryhet me anë të një instrumenti ligjor matës të përshtatshëm për kryerjen e veprimeve të nevojshme.

Kontrolli mund të kryhet nëpërmjet marrjes së mostrave.

Kur përmbajtja aktuale nuk matet, kontrolli i kryer nga paketuesi duhet të organizohet në mënyrë të tillë që sasia e përmbajtjes të sigurohet në mënyrë efektive.

Ky kusht plotësohet nëse paketuesi kryen kontrollet e prodhimit në përputhje me procedurat e pranuar nga AMK dhe nëse mban në dispozicion të departamenteve kompetente të AMK-së dokumentet që përmbajnë rezultatet e kontrolleve të tilla, për të vërtetuar se këto kontrolle, së bashku me ndonjë korrigjim dhe përshtatje që ata kanë konsideruar të nevojshme, janë kryer siç duhet dhe me saktësi.

Në rastin e importeve nga një vend jashtë BE-së, importuesi në vend të matjes dhe kontrollit mund të sigurojë dëshmi se posedon të gjitha garancitë e nevojshme që i mundësojnë marrjen e përgjegjësisë.

Në rastet e produkteve me sasi të shprehura në njësi të vëllimit, një nga metodat e shumta për plotësimin e kërkesave të matjes dhe kontrollit është që si enë matëse, kur bëhet parapaketimi, të përdoret një enë matëse e tipit të përcaktuar në rregullat mbi shishet si enë matëse.

5. VERIFIKIMET QË DUHET T'I KRYEJNË ZYRTARËT E AMK-SË NË AMBIENTET E PAKETUESIT, TË IMPORTUESIT OSE TË AGJENTIT TË TYRE

Verifikimet për të siguruar që para-paketimet janë në përputhje me dispozitat e kësaj rregullore, duhet kryer nga zyrtarët AMK-së, nëpërmjet mbledhjes së mostrave në ambientet e paketuesit ose, nëse kjo nuk është e mundur, në ambientet e importuesit ose të agjentit të tyre.

Ky verifikim statistikor kryhet në përputhje me metodat e pranura të inspektimit për pranueshmëri të cilësisë. Efektiviteti i saj duhet të jetë i krahasueshëm me metodën referuese të specifikuar në Shtojcën II.

Kështu që, sa i përket kriterit për përmbajtjen minimale, një plan i mostrimit i përdorur nga AMK do të konsiderohet i krahasueshëm me atë të rekomanduar në Shtojcën 2 nëse abshisa e pikës 0.10 të koordinatave të kurbës karakteristike të veprimit të planit të parë (probabiliteti i pranimi të serisë = 0.10) devijon me më pak se 15% nga abshisa e pikës përkatëse të kurbës karakteristike të funksionimit të planit të mostrimit të rekomanduar në Shtojcën 2.

Sa i përket kriterit për mesataren e llogaritur me metodën e devijimit standard, një plan i kampionimit i përdorur nga AMK do të konsiderohet i krahasueshëm me atë të rekomanduar në Shtojcën 2, nëse, duke marrë parasysh kthesat karakteristike të funksionimit të dy planeve që kanë aksin e abshisës ($Q_n - m$)/s, abshisa e pikës 0.10 të rendit të kurbës së planit të parë (probabiliteti i pranimi të serisë = 0.10) devijon nga më pak se 0.05 nga abshisa e pikës përkatëse të kurbës së planit të mostrimit të rekomanduar në Shtojcën 2.

6. VERIFIKIMET TJERA TË KRYERA NGA AMK Kjo Rregullore nuk do të përjashtojë asnjë verifikim që mund të kryhet nga AMK në çdo fazë të procesit të marketingut, në veçanti me qëllim të verifikimit se parapaketimet i përmbushin kërkesat e kësaj Rregullore.



SHTOJCA II

METODAT E KONTROLLIT

Kjo Shtojcë përcakton procedurat e metodës së referimit për kontrollin statistikor të serisë të parapaketimeve për të përmbushur kërkesat e nenit 3 të kësaj Rregullore.

1. KËRKESAT PËR MATJEN E PËRMBAJTJES REALE TË PARAPAKETIMEVE

Përmbajtja reale e parapaketimeve mund të matet drejtpërsëdrejti duke përdorur mjetet matëse të masës ose vëllimit ose, në rastin e lëngjeve, në mënyrë indirekte, duke matur masën e produktit të parapaketuar dhe dendësinë e tij.

Pavarësisht metodës së përdorur, gabimi në matjen e përmbajtjes reale të parapaketimit nuk duhet të tejkalojë një të pestën e gabimit të lejueshëm negativ për sasinë nominale në parapaketim.

Procedura për matjen e përmbajtjes reale të një parapaketimi mund të jetë temë e procedurave të AMK-së.

2. KËRKESAT PËR KONTROLLIMIN E SERISË SË PARAPAKETIMEVE

Kontrolli i parapaketimeve duhet të kryhet me marrjen e mostrave dhe duhet të jetë në dy pjesë:

- një kontroll që mbulon përmbajtjen reale të çdo parapaketimi në mostër,
- kontrolli tjetër mbi mesataren e përmbajtjes reale të parapaketimeve në mostër.

Një seri e parapaketimeve do të konsiderohet e pranueshme nëse rezultatet e të dy kontrolleve i përmbushin kriteret e pranimi.

Për secilën nga këto kontrolle, ekzistojnë dy plane të marrjes së mostrave:

- njëra për testimin jo-dëmtues, d.m.th. testimin që nuk përfshin hapjen e paketimit,
- tjetra për testimin dëmtues, d.m.th. testimin që përfshin hapjen ose prishjen e paketimit.

Për arsye ekonomike dhe praktike, testi i fundit do të kufizohet në minimumin absolut thelbësor; është më pak efikas se testi jo dëmtues.

Pra, testimi dëmtues duhet të përdoret vetëm atëherë kur testimi jo dëmtues është jo praktik. Si rregull i përgjithshëm, kjo nuk do të aplikohet tek seritë me më pak se 100 njësi.

2.1. Seritë e parapaketimit

2.1.1. Seria përfshin të gjitha parapaketimet e të njëjtës sasi nominale, të njëjtit lloj dhe të njëjtës linjë të prodhimeve, të paketuara në të njëjtin vend, të cilat duhet inspektuar. Sasia e serisë kufizohet në shumat e përcaktuara më poshtë.

2.1.2. Pas kontrollimit të parapaketimeve në fund të linjës së paketimit, numri në çdo seri duhet të jetë i barabartë me prodhimin maksimal për orë të linjës së paketimit, pa asnjë kufizim sa i përket sasisë së serisë.

Në rastet tjera, sasia e serisë duhet të kufizohet në 10 000.

2.1.3. Për seritë me më pak se 100 parapaketime, testi jo dëmtues, për cilat është kryer testi, ai test duhet të jetë 100%.

2.1.4. Para kryerjes së testeve të përmendura në pikën 2.2 dhe 2.3, një numër i konsiderueshëm i parapaketimeve duhet të nxirret në mënyrë të rastësishme nga seria, në mënyrë që të mund të kryhet kontrolli që kërkon mostër më të madhe.

Për kontrollin tjetër, mostra e nevojshme duhet të nxirret në mënyrë të rastësishme nga mostra e parë dhe duhet të shënjohe.

Ky operacion shënjimi duhet të përfundojë para fillimit të veprimeve matëse.

2.2. Kontrollimi i përmbajtjes reale të një parapaketimi

Përmbajtja minimale e pranueshme do të llogaritet duke zbritur gabimin e tolerueshëm negativ për përmbajtjen në fjalë nga sasia nominale e paketimit.

Parapaketimet në seri, përmbajtja reale e të cilave është më e vogël se përmbajtja minimale e pranueshme do të konsiderohen me defekt.

2.2.1. Testimi jo-dëmtues

Testimi jo-dëmtues duhet të kryhet në përputhje me planin e mostrimit të dyfishtë, siç paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Numri i parë i parapaketimeve të kontrolluara duhet të jetë i barabartë me numrin e njësive në mostrën e parë, siç tregohet në plan:

- nëse numri i njësive të dëmtuara të gjetura në mostrën e parë është më e vogël ose e barabartë me kriterin e parë të pranimit, grupi do të konsiderohet i pranueshëm për qëllimin e këtij kontrolli,
- nëse numri i njësive me defekt të gjetura në mostrën e parë është e barabartë ose më e madhe se kriteri i parë i refuzimit, seria do të refuzohet,

- nëse numri i njësive me defekt të gjetura në mostrën e parë qëndron ndërmjet kriterit të parë të pranimit dhe kriterit të parë të refuzimit, duhet të kontrollohet një mostër e dytë, numri i njësive në të cilën tregohet në plan.

Njësitë me defekte të gjetura në mostrat e para dhe të dyta do të mblidhen dhe:

- nëse numri total i njësive me defekte është më i vogël ose i barabartë me kriterin e dytë të pranimit, seria do të konsiderohet e pranueshme për qëllimet e këtij kontrolli,
- nëse numri i mbledhur i njësive me defekt është më i madh ose i barabartë me kriterin e dytë të refuzimit, seria do të refuzohet.

Numri në seri	Mostrat			Numri i njësive me defekt	
	Rendi	Numri	Numri i mbledhur	Kriteri i pranimit	Kriteri i refuzimit
100 deri 500	1 –rë	30	30	1	3
	2 –të	30	60	4	5
501 deri 3200	1 –rë	50	50	2	5
	2 –të	50	100	6	7
3201 dhe më lart	1 –rë	80	80	3	7
	2 –të	80	160	8	9

2.2.2. Testimi dëmtues

Testimi dëmtues do të kryhet në përputhje me planin e vetëm të mostrave më poshtë dhe përdoret vetëm për seritë prej 100 ose më shumë parapaketime.

Numri i paketimeve të kontrolluara do të jetë i barabartë me 20.

- Nëse numri i njësive me defekte të gjetura në mostër është më i vogël ose i barabartë me kriterin e pranimit, seria e parapaketimeve do të konsiderohet si e pranueshme.
- Nëse numri i njësive me defekt të gjetura në mostër është i barabartë ose më i madh se kriteri i refuzimit, atëherë seria i parapaketimeve refuzohet.

Numri në seri	Numri në mostër	Numri i njësive me defekt	
		Kriteri i pranimi	Kriteri i refuzimit
Çfarëdo numri (≥ 100)	20	1	2

2.3. Kontrollimi i përmbajtjes mesatare reale të parapaketimeve individuale që përbëjnë një seri

2.3.1. Një seri e parapaketimeve do të konsiderohet e pranueshme për qëllime të këtij kontrolli, nëse vlera mesatare $\bar{x} = \frac{\sum x_i}{n}$ n e përmbajtjes reale x_i e n parapaketimeve në një mostër është më e madhe se vlera:

$$Q_n - \frac{s}{\sqrt{n}} * t_{(1-\alpha)}$$

Në këtë formulë:

Q_n = sasia nominale e parapaketimit,

n = numri i parapaketimeve paraprake në mostrën për këtë kontroll,

s = devijimi standard i vlerësuar i përmbajtjes reale të serisë,

$t_{(1-\alpha)} = 0,995$ niveli i besimit së një distribucioni me $v = (n - 1)$ shkallë të lirisë.

2.3.2. Nëse x_i është vlera e matur për përmbajtjen reale të artikullit i në mostër që përmban n artikuj atëherë:

2.3.2.1. mesatarja e vlerave të matura për mostrën nxirret nga llogaritja e mëposhtme:

$$\bar{x} = \left(\sum_{i=1}^{i=n} x_i \right) / n$$

2.3.2.2. dhe vlera e parashikuar e devijimit standard s nga llogaritja e mëposhtme:

- shuma e katrorëve të vlerave të matura:

$$\sum_{i=1}^{i=n} (x_i)^2$$

- katrori i shumës së vlerave të matura:

$$\left(\sum_{i=1}^{i=n} x_i \right)^2$$

atëherë

$$\frac{1}{n} \left(\sum_{i=1}^{i=n} x_i \right)^2$$

- shuma e korigjuar:

$$SC = \sum_{i=1}^{i=n} (x_i)^2 - \frac{1}{n} \left(\sum_{i=1}^{i=n} x_i \right)^2$$

- varianca e vlerësuar:

$$v = \frac{SC}{n-1}$$

Vlera e parashikuar e devijimit standard është: $s = \sqrt{v}$

2.3.3. Kriteret për pranimin ose refuzimin e serisë së parapaketimeve për kontrollimin e mesatares:

2.3.3.1. Kriteret për testimin jo dëmtues

Numri në seri	Numri në mostër	Kriteret	
		Pranimi	Refuzimi
100 deri 500 (gjithëpërfshirëse)	30	$\bar{x} \geq Q_n - 0.503s$	$\bar{x} < Q_n - 0.503s$
> 500	50	$\bar{x} \geq Q_n - 0.379s$	$\bar{x} < Q_n - 0.379s$

2.3.3.2. Kriteret për testimin dëmtues

Numri në seri	Numri në mostër	Kriteri	
		Pranimi	Refuzimi
Çfarëdo numri (≥ 100)	20	$\bar{x} \geq Q_n - 0.640s$	$\bar{x} < Q_n - 0.640s$



SHTOJCA III

DIAPAZONET E SASIVE NOMINALE TË PËRMBAJTJES SË PARAPAKETIMEVE

1. *Produktet e shitura sipas vëllimit (sasia në ml)*

Verë e pagazuar	Në intervalin nga 100 ml deri në 1 500 ml vetëm 8 sasi nominale si vijon: ml: 100 - 187 - 250 - 375 - 500 - 750 - 1 000 - 1 500
Verë e verdhë (e bardhë)	Në intervalin nga 100 ml deri në 1 500 ml vetëm sasia nominale si vijon: ml: 620
Verë e gazuar	Në intervalin prej 125 ml deri në 1 500 ml, vetëm 5 sasitë nominale si vijon: ml: 125 - 200 - 375 - 750 - 1 500
Verë liker	Në intervalin prej 100 ml deri në 1 500 ml vetëm 7 sasi nominale si vijon: ml: 100 - 200 - 375 - 500 - 750 - 1 000 - 1 500
Verë e aromatizuar	Në intervalin prej 100 ml deri në 1 500 ml vetëm 7 sasi nominale si vijon: ml: 100 - 200 - 375 - 500 - 750 - 1 000 - 1 500
Pije alkoolike (pije të forta)	Në intervalin prej 100 ml deri në 2 000 ml, vetëm 9 sasitë nominale si vijon: ml: 100 - 200 - 350 - 500 - 700 - 1 000 - 1 500 - 1 750 - 2 000


2. Përkufizimet e produktit

Verë e pa gazuar	Vera e përcaktuar në Nenin 1(2)(b) të Rregullores së Këshillit (EC) Nr. 1493/1999 e datës 17 Maj 1999 për organizimin e përbashkët të tregut të verës (Kodi NC 2204).
Verë e verdhë (e bardhë)	Vera e përcaktuar në Nenin 1 (2) (b) e Rregullores (EC) Nr 1493/1999 (Kodi NC 2204) me emërtimin e prejardhjes: ‘Côtes du Jura’, ‘Arbois’, ‘L'Etoile’ dhe ‘Château-Chalon’ në shishe, siç është përcaktuar në Shtojcën I, pika 3 Rregullores së Komisionit (EC) Nr 753/2002 e datës 29 prill 2002 që i përcakton disa rregulla për aplikimin e Rregullores së Këshillit (EC) Nr 1493/1999 sa i përket përshkrimit, emërimit, prezantimit dhe mbrojtjes së disa produkteve të sektorit të verës.
Verë e gazuar	Vera e përcaktuar në Nenin 1 (2) (b) dhe në Shtojcën I, pikat 15, 16, 17 dhe 18 të Rregullores (KE) Nr. 1493/1999 (Kodi CN 2204 10).
Verë liker	Vera e përcaktuar në Nenin 1 (2) (b) dhe në Shtojcën I, pika 14 e Rregullores (KE) Nr. 1493/1999 (Kodi CN 2204 21 - 2204 29).
Verë e aromatizuar	Vera e aromatizuar e përcaktuar në Nenin 2 (1) (a) të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 1601/91 e datës 10 qershor 1991 për përcaktimin e rregullave të përgjithshme për përkufizimin, përshkrimin dhe paraqitjen e verërave të aromatizuara, pijeve të aromatizuara me bazë verë dhe - kokteje nga produktet e verës (Kodi CN 2205).
Pije alkoolike (pije të forta)	Pije të forta siç është përcaktuar në nenin 1 (2) të Rregullores së Këshillit (EEC) nr. 1576 / 89 të 29 majit 1989 që përcakton rregullat e përgjithshme për përkufizimin, përshkrimin dhe paraqitjen e pijeve alkoolike (Kodi CN 2208).



SHTOJCA IV

SHENJA EVROPIANE "e" E KONFORMITETIT TË PARAPAKETIMEVE



Shenja evropiane "e": Paraqitja grafike e formës dhe përmasa



ANNEX I

OBJECTIVES AND BASIC PROVISIONS

1. OBJECTIVES

Prepackages covered by this Regulation shall be made up in such a way that the completed packages satisfy the following requirements:

